



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE

DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt.19.12.2023]

**Lënda:** Njoftimi i shkurtuar i Kontratës i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike për procedurën e prokurimit me objekt: "Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës".

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**  
BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË

### **NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**

#### **1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

Emri Bashkia e Tiranës  
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"  
Tel/Faks: 00 355 4 22 56 799  
E-mail: [administrative.prokurime@tirana.al](mailto:administrative.prokurime@tirana.al)  
Ueb-faqe [www.tirana.al](http://www.tirana.al)

**2. Lloji i procedurës së prokurimit:** "Procedurë e hapur"

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-91659-12-19-2023

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** "Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës".

**5. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës:** **11.249.666 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë)** lekë pa tvsh, me objekt: "Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës", vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr. 126 dt 23.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023" i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

1. **”Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës”**, në programin buxhetor ”Investim (231)” me tipologji **”Sistem softëare”** me vlerë të fondit limit 3.750.000 (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.
2. **”Zhvillime, përmirësime dhe mirëmbajtje e sistemit GIS në Bashkinë e Tiranës”**, në programin buxhetor ”Shpenzime operative (602)” me tipologji **”mirëmbajtje +trajnim”** me vlerë të fondit limit 7.499.500 (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

*Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet.*

**6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** Data e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 3 (tre) muaj nisur nga kjo datë për implementimin e detyrave dhe 24 (njëzetë e katër) muaj duke filluar nga data e marrjes në dorëzim, do të jetë periudha e mirëmbajtjes së sistemit.

**7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 04.01.2024 ora 12.30**